



## Çka vërtet është “ Down-Syndrom”-i?

Të dhënat shkencore rreth temës Down-Syndrom

Në përgjithësi çdo njeri ka 23 kromozome të dyfishta. Në të janë të gjitha informacionet gjenetike të ruajtura, si p.sh. sytë, lëkura apo ngjyra e flokëve . Tek njerëzit me Down-Syndrom, kromozoni i 21-të është trefishë , në vend se të jetë normal dyfishë. Kjo është arsyeja pse ai është quajtur edhe trisomy 21. Përafërsisht çdo i 800-ti fëmijë vjen në këtë botë me këtë Down-Syndrom. Vetëm në Hamburg janë më shumë se 2.250 njerëz që jetojnë me Down-Syndrom. Emërimi i këtij ndryshimi gjenetik u morrë sipas mjekut anglez Langdon-Down, i cili ishte i pari që përshkroi karakteristikat e veçanta të këtyre njerëzve. Përveç një sensi të mirë të orientimit, njerëzit me Down-Syndrom janë veçanërisht miqësor, me humor dhe të hapur. Megjithatë, ata janë në karakterin dhe dëshirat e tyre plotësisht individual si njerëzit e tjerë. Trashëgimia e ndryshuar mund të çoj deri te problemet medicinale: defektet e zemrës, të shkaktoj tonusin e dobët të muskujve apo dëmtimin e dëgjimit. Në parim, zhvillimi i gjithëmbarshtëm mendor dhe fizik është i vonuar, kështu që zhvillimet individuale janë shumë të ndryshme. Në vitet e fundit, janë përmirësuar mundësitë e financimit e kështu që një numër i mirë i personave me Down-Syndrom, mësojnë shkrim-leximin, dhe si të rritur, në masë të madhe, mund të bëjnë një jetë të pavarur.

KIDS Hamburg e.V. Kontakt dhe Qendra informative Down-Syndrom ka vendosur si qëllim që të përfaqësojë intereset e njerëzve me Down-Syndrom. Shoqata dëshiron që të promovojë kontakte dhe të kyç anëtarët e familjes, terapistët dhe të interesuarit për tematikën e “Down-Syndrom”-it. Si qëllim të mëtutjeshëm paraqesim informimin publik rreth trizomit 21, për të ndërprerë paragjykimet dhe për të promovuar zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Aktivitetet edukativo-rekreative për grupmosha të ndryshme, seminare dhe mundësitë e gjithëmarshme të konsultimit i përkasin punës së shoqatës KIDS Hamburg e.V. Shoqata ka tani rreth 380 anëtarë dhe financohet kryesisht nga anëtarësia dhe donacionet.

### Çdo i interesuar është i mirëseardhur!

Kontakti: KIDS Hamburg e.V.  
Kontakt- und Informationszentrum Down-Syndrom  
Heinrich-Hertz-Str. 72  
22085 Hamburg  
Tel.: 040-38616780  
[info@kidshamburg.de](mailto:info@kidshamburg.de)  
[www.kidshamburg.de](http://www.kidshamburg.de)

Ju doni me donacion të na mbështesni?

Ne jemi një organizatë jofitimprurëse dhe ne mund të ju lëshojmë një faturë për donacion.

Gjirolllogaria për donacion: Haspa Hamburg, BLZ 200 505 50, Kto. 1238 142 952  
IBAN DE97200505501238142952, BIC HASPDEHHXXX